



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË, KULTURËS DHE INOVACIONIT
TEATRI KOMBËTAR I OPERËS, BALETIT DHE ANSAMBLIT POPULLOR
DREJTORIA E FINANCËS DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
SEKTORI I SHËRBIMEVE

Nr. 612/prot.

Tiranë, më 11.06.2024

NJOFTIM

TKOBAP, në zbatim të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi Punës i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjit nr. 44/2015 “Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 90, datë 27.09.2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”, ligjit nr. 10 352, datë 18.11.2010 “Për artin dhe kulturën”, i ndryshuar, VKM-së nr. 176, datë 29.03.2006 “Për botimin e buletinit të njoftimeve publike”, Urdhrit të Kryeministrit nr.140, datë 28.03.2014 “Për miratimin e strukturës dhe të organikës të TKOBAP”, Statutit të TKOBAP-së miratuar me urdhër të Ministrit të Kulturës nr. 166, datë 27.04.2015 dhe Rregullores së Brendshme për Organizimin dhe Funksionimin e TKOBAP-së, **shpall 1 (një) vend vakant për pozicionin e punës “Drejtor pranë Drejtorisë së Baletit (BaletMaestër)”**.

Kërkesat e përgjithshme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të jetë shtetas shqiptar ose i huaj
2. Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse
3. Të përmbushë kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës
4. Të mos jetë dënuar me vendim të formës së prerë të gjykatës për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje
5. Ndaj tij të mos jetë marrë masë disiplinore e largimit nga puna për shkak të një shkeljeje të rëndë disiplinore.

Kërkesat e posaçme që duhet të plotësojnë personat që aplikojnë:

1. Të ketë përfunduar studimet në degën e baletit brenda ose jashtë vendit
2. Të ketë përvojë pune jo më pak se 10 vjet në fushën e artit skenik si balerin ose baletmaestër
3. Të ketë një biografi që demonstroi një karrierë me njohje të qartë ndërkombëtare
4. Të ketë aftësi të mira koordinimi dhe organizimi të një trupe baleti
5. Të ketë aftësi të dallueshme komunikimi në ruajtje dhe zhvillim të kontakteve brenda dhe jashtë institucionit
6. Të ketë njohuri të mira të gjuhës angleze

Përgjegjësitë/Detyrat kryesore të Drejtorit pranë Drejtorisë së Baletit (BaletMaestër):

1. Në përputhje me platformën drejtuese të Drejtorit të Përgjithshëm propozon platformën artistike të zhvillimit të veprimtarisë artistike të Drejtorisë së Baletit.
2. I propozon Drejtorit të Përgjithshëm objektivat e performancës artistike të drejtorisë së tij përgjatë vitit artistik në përputhje me objektivat e drejtorit të përgjithshëm si dhe ai është përgjegjës për zbatimin e tyre.
3. I propozon Drejtorit të Përgjithshëm kalendarin vjetor artistik të drejtorisë së tij.
4. Drejton dhe organizon punën e stafit artistik për implementimin e kalendarit artistik të TKOBAP-së.
5. Në bashkëpunim me Dirigjentin e Baletit planifikon planin e provave.
6. Negocion me partnerë vendas dhe të huaj për organizimin e turneve brenda dhe jashtë vendit.
7. I propozon Drejtorit të Përgjithshëm projekte bashkëpunimi me subjekte apo individë artistë brenda dhe jashtë vendit.
8. I propozon Drejtorit të Përgjithshëm thirrje për aplikim për projekte alternative të artit klasik dhe kontemporan.
9. Organizon audicione për rolet solistike për veprat pjesë e kalendarit artistik të TKOBAP-së.

Dokumentacioni, mënyra dhe afati i dorëzimit të tyre:

1. Letër shprehje interesi për pozicionin e punës së shpallur
2. Jetëshkrimi (CV)
3. Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
4. Fotokopje e diplomës dhe e listës së notave të noterizuara
5. Çdo dokument tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive, rekomandime apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e kandidatit
6. Fotokopje të librezës së punës
7. Dëshmi e gjendjes gjyqësore

Mosparaqitja e plotë dhe në kohë e dokumenteve sjell skualifikimin e aplikantit.

Dokumentacioni do të dorëzohet pranë Zyrës së Protokollit ose i skanuar në adresën në postën elektronike zyrtare të TKOBAP-së deri në datën 10.7.2024 me objekt: Aplikim për pozicionin e punës “Drejtor pranë Drejtorisë së Baletit (BaletMaestër)”.

Pas verifikimit të dokumentave të depozituara, aplikantët të cilët plotësojnë kriteret e kërkuara, do të lajmërohen nëpërmjet e-mail-it për zhvillimin e intervistës së strukturuar me gojë brenda 7 (shtatë) ditëve nga afati i fundit për dorëzimin e dokumentacionit të kërkuar për pozicionin e punës.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Abigeila Voshtina

